



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:174829

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05682068

C.nr.628/13

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Fëllanza Knushaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.SH., nga fshati ..., komuna e Prizrenit, kundër të paditurit M,LL nga fshati ....., komuna e Gjakovës, me bazë juridike kthim i borxhit, vlera e objektit të kontestit 15,915.00 Euro, në seancën përgatitore të datës 14.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e evidentuar me numër C.nr.628/13, e datës 14.02.2006, e paditësit K.SH., nga fshati ..., komuna e Prizrenit, tani me adresë të panjohur, kundër të paditurit M.LL., nga fshati ....., komuna e Gjakovës, në çështjen juridike kontestimore kthim i borxhit, vlera e objektit të kontestit 15,915.00 euro.
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij E.R, në këtë gjykatë me datë 14.02.2006 ka paraqitur padi për kthim borxhi ndaj të paditurit M.LL., vlera e objektit të kontestit 15,915.00 euro.

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka caktuar seancën përgatitore me datë 27.02.2024, ku i autorizuari i paditësit, para fillimit të seancës, përmes parashtesës së datës 23.02.2024 ka lajmëruar gjykatën se nuk do të marrë pjesë në seancë për shkak se paditësi ka revokuar autorizimin ndaj tij. Atëherë gjykatë në seancën e radhës ka vendosur që komunikimin ta realizoi me paditësin në adresën si në padi.

Në seancën përgatitore të datës 18.04.2024, pasi që gjykata kishte konstatuar se në fletëkthesën për paditësin ishte konstatuar se “*paditësi jeton jashtë vendit*”, ka vendosur që komunikimin me paditësin ta realizoi përmes tabelës së shpalljeve të kësaj gjykate sepse paditësi nuk ka njoftuar

gjykatën për ndërrim të adresës, siç është obliguar nga dispozitave ligjore të nenit 116 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore ka caktuar seancën përgatitore me datë 14.05.2024, në të cilën nuk ka prezantuar paditësi edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt përmes tabelës së shpalljeve të kësaj gjykate, e po ashtu nuk ka prezantuar as e paditura për të cilën gjykata nuk kishte prova se ishte ftuar në mënyrë të rregullt.

Sipas nenit 409, par.1 të LPK-së, ku është përcaktuar se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.”*, e që në rastin konkret paditësi ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën për seancë nuk e ka arsyetuar, e po ashtu nuk ka prezantuar as e paditura, që të mund të deklarohej rreth mbajtjes së seancës përgatitore në mungesë të palës paditëse. Andaj gjykata erdhi në përfundim se padia e paditësit duhet të konsiderohet e tërhequr në këtë çështje kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe në mbështetje të nenit 409, pika 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. 628/13, datë 14.05.2024

Gjyqtarja  
Fëllanza Knushaj

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.